

PËRBËRJA E NXËNËSVE TË SHKOLLËS

Shumica e nxënësve të shkollës përbëhet nga fëmijë vendas me prindër me privilegje të kufizuara. Më poshtë jepet numri i nxënësve sipas viteve shkollore nga 1998/99 deri më 2008/09 në të cilën shkolla funksiononte dhe funksionon si 12 vendëshe dhe si ndërkulturore në ndërtesën e re.

Viti shkollor	1998 /99	1999 /00	2000 /01	2001 /02	2002 /03	2003 /04	2004 /05	2005 /06	2006 /07	2007 /08	2008 /09
Vendas	194	200	227	234	237	252	255	244	240	227	217
Të riatdhesuarit	68	52	34	28	25	22	28	34	31	30	31
Të huajt	11	17	14	16	20	27	32	34	44	46	47
Ciganëve	14	11	10	19	22	22	21	24	26	28	29
Gjithsej	287	280	285	297	304	323	336	336	341	331	324

Fëmijët ciganë ku janë të regjistruar në shkollën tonë, (gjatë vitit shkollor 2008/09) siç duket dhe nga gjendja e më sipërme janë 29 nxënës. Më të shumtit prej tyre ndjekin mësim në klasa parapërgatitore (paradite) dhe në KPM (klasa përforcuese të mësimdhënies), ndërsa të tjerët ndjekin rregullisht mësimet në klasat e tyre.

Në shkollën tonë studiojnë dhe 47 të huaj (22 prej tyre lindën në Greqi), nga të cilët 37 janë Shqiptarë dhe pjesa tjetër prej 8 nxënësish janë të kombësive të ndryshme: (3 Armenë, 3 Rusë, 3 Gjeorgjiani dhe 1 Rumani)

Të riatdhesuarit, quhen nxënësit të cilët lindën jashtë shtetit, u kthyen në Greqi dhe kanë marrë shtetësi Greke.

31 të riatdhesuarit të këtij viti lindën në këto shtete: (4 në Rusi, 5 në Gjeorgji, 17 në Gjermani, 4 në Kazakistan, 1 në Qipro)

Ndodhen dhe 82 nxënës vendas, të cilët prindërit e tyre erdhën në përgjithësi nga vendet e ish Bashkimit Sovjetik (prindër të riatdhesuar).

Disa (minimumi) nga këta fëmijë kanë probleme mësimore. Prindërit e tyre nuk flasin dhe as nuk njohin mirë gjuhën greke, si pasojë të mos munden të ndihmohen nga ata në shtëpi.

Përqindja e të riatdhesuarve dhe të të huajve është **24,07 %**

Përqindja e të riatdhesuarve, të të huajve dhe të ciganëve në përgjithësi në shkollë është **30,86 %**.